



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE, LEGJISLACIONIT DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE
KOORDINATOR I KONSULTIMIT PUBLIK

Nr. 1511 / Prot.
13

Patos, më 06/05 / 2026

NJOFTIM

**Dëgjesë publike me temë:
“Plani Lokal i Cilësisë së Ajrit 2026-2028”**

Në zbatim nenit 18 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, ligjit nr. 146/2012 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, Rregullores së Këshillit Bashkiak “Për konsultimin publik”, si dhe kërkesës së Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik me nr. 250/1, datë 29.04.2026 për realizimin e konsultimit publik për Planin Lokal të Cilësisë së Ajrit.

Ju njoftojmë se:

Ditën e **Mërkurë** në datë **10.06.2026 ora 11:30**, në ambientet e sallës së Këshillit Bashkiak Patos do të organizohet takimi konsultativ me përfaqësues të: anëtarë të Këshillit Bashkiak; kryetarë të fshatrave; grupe interesi; banorë të zonës; insitucione publike dhe jopublike; OJF; shoqëri civile; qytetarë të njësive administrative dhe të qytetit; përfaqësues të bashkisë Patos, me temë: **“Plani Lokal i Cilësisë së Ajrit 2026-2028”**.

Ky konsultim publik synon të njoh gupet e interesit me analizën e situatës, qëllimin e planit, objektivat mbi planin e hartuar. Gjithashtu synon të marr mendimet dhe komentet mbi këtë plan për përmirësimin e dokumentit drejt planit final.

Komentet dhe rekomandimet e grupeve të interesit janë të mirëpritura, brenda 20 ditëve pune nga data e njoftimit për procesin e njoftimit e të konsultimit publik në adresën e email-it: info@bashkiapatos.gov.al.

Pjesëmarrja juaj në këtë dëgjesë publike është shumë e rëndësishme për garantimin e një procesi sa më transparent dhe gjithëpërfshirës.

KRYETARI
Fation Duro